

SHKËLZEN RAÇA

DISA ASPEKTE STUDIMORE MBI SULIN DHE SULJOTËT

Rruga për në malet e pakalueshme të Sulit, pra aty ku dikur u ndërtua epopeja e famshme e valles së vdekjes të suljotëve¹, edhe pse në një lartësi mbi 1200 metra mbi det, duket se nuk është vështirë për t'u gjetur. Mjafton që çdo kalimtar i rastit të ndjekë me kujdes rrugën kombëtare, e cila lidh qytezën e re joniane, Gumenicën me kryeqendrën e Greqisë, Athinën nëpërmjet Paramithisë. Si bazë orientimi për të marrë rrugën e Sulit është fshati Gliqi. Në pjesën lindore të këtij fshati gjendet ura, nën të cilën kalon lumi Aheron, që e ndan prefekturën e Çamërisë nga ajo e Prevezës.

Nga cilido kënd i Gliqisë, me të kthyer shikimin kah veriu, shtegu i rrugës kombëtare mund ta dërgojë çdo kalimtar nga rrugët gjarpërore njëra pranë tjetrës, të cilat së bashku marrin pamjen e një peizazhi të egër. Jo larg nga aty janë shkallët e Xhavelasve, më pas rrënja e lartësisë së vendit të quajtur edhe sot Qafa (Kiafa) dhe sipër saj një hapësirë relativisht e madhe mbishkrimi shkronjash të mëdha, me emrin Sul. Është pikërisht ky rajon, me maja të larta e pamje të vrazhda, që dikur ka bartur emrin Kasiopi. Përndryshe, janë katër fshatra të Sulit: Qafa, Avariku, Samoniva e Suli², sot me fare pak shtëpi banimi, të cilat nëpërmjet grykës së Avarikut dhe dy kodrave: Qafës dhe Kungjisit, mundësojnë hyrjen në zonën e Sulit të zhveshur nga gjelbërimi.

¹ Për topografinë e Sulit dhe ngjarjen tragjike të Zalongjit, më gjerësisht: William Martin-Leak, *Travels in Northern Greece*, Vol.I, London: 1825, f. 224-234; François C.H.L Pouqueville, *Voyage de la Grece*, Vol 2, Paris: 1826-1827, f. 214-223; Thomas Smart Hughes, *Travels in Greece and Albania*, vol.2, London: 1830, f. 136-138; Γεώργιος Λαμπρίδης, *Ἡπειρωτικά Μελετήματα*, τόμος 10, "Τα Σουλιωτικά" Αθήναι 1971, f. 7-17; Γεώργιος Μ. Σαρηγιάννης, *Η δημιουργία, η εξέλιξη και η συγκρότηση της Σουλιώτικης ομοσπονδίας (16-ος-18ος αί)*, Ίωάννινα: 1981, f. 8-11; Ε.Δ.Μ, *Τα ηρωικά θαυμάτα των Σουλιωτών και Σουλιωτίδων* (εκδόσεις δεύτερα) ἐν Λονδίνο: 1887, f. 233-234; Σπύρος Μελάς, *Τό λιοντάρι της Ηπείρου, Αλί Πασάς και Σούλι - παραμονες τοῦ 21*(pa datë botimi), f. 174-180.

² *Μεγάλη Ελληνική Εγκυκλοπαίδεια*, τ. ΚΒ, Αθήνα: 1933, f. 142.

Historia e Sulit, që jo rrallë është emëruar prej ndonjë anasi aty, si Kakësuli³, është e shumanshme, komplekse dhe me plot dilema për studiuesit bashkëkohorë. Shumëçka për Sulin dhe suljotët, të konsideruar ndër banorët më të hershëm aty, nuk ka marrë përgjigje. Shumë pyetje kërkojnë përgjigje: Prej nga vjen emri Sul? Kur u popullua ai terren shkëmbor e i lartë, gati i pakalueshëm për shumëkënd? Mos vallë suljotët ishin vendas e më pak të ardhur, apo në fund të fundit, para se të vinin në Sul, kishin qenë herët, madje shumë herët, në terrenet e Çamërisë pjellore? Padyshim që shumë nga këto pyetje e dilema do të ishin zgjidhur sikur ndonjë gjurmues t'i kishte hyrë vjeljes së bazës dokumentare osmane, venedikase apo ndonjë thesari tjetër të vlefshëm në këtë hapësirë studimi.

Megjithatë, tani për tani, duke u mbështetur në ato pak shkrime, për këtë vend malor e malësorët e tij të papërkulur, mbetemi të detyruar t'i referohemi bibliografisë, relativisht të pasur të historiografisë evropiane e asaj ballkanike, kryesisht greke. Autorët e shumë artikujve e jo pak veprave që shtrojnë e trajtojnë aspekte të ndryshme studimore rreth Sulit e suljotëve, dje dhe sot u përballën e po përballen me dilemave të konsiderueshme, në funksion të trajtimit sa më objektiv të fenomenit historik e demografik të këtij rajoni sipër Çamërisë e banorëve të tij.

E mendoj të arsyeshme që këtë artikull ta nis nga shqyrtimi i pyetjes së parë, për të vënë në pah reminishencën e krijimit të Sulit, si rajon malor i populluar dendur deri në fillimet e shek. XIX dhe më pas, i zbrazur nga suljotët. Çon jetën e vet në këtë vend të zhveshur aty këtu ndonjë i moshuar, i cili e ka të vështirë të lërë tokën e Marko Boçarit dhe ende është krenar për bëmat e paraardhësve të vet. Për më tepër, shumë nga suljotët sot vazhdojnë të përkujtojnë rrënjët e forta në viset shkëmbore të Sulit dhe nëpërmjet toponimisë nuk e kontestojnë origjinën shqiptare të tyre. Në këtë kontekst, siç bën të ditur albanologu grek me prejardhje shqiptare, Petro Furiqi (Πέτρο Φουρίκης), toponimet si: Qafa, Vira ose Bira, Breku i vetetimesë (Bregu i vetëtimës), Gura, Dhembes (Dhëmbës), Kungje, Murga e Fereza⁴, nuk kanë si të shpjegohen ndryshe, përveçse nëpërmjet gjuhës shqipe.

³ William Eton, *Tableau historique, politique et moderne de l'empire Ottoman*, traduit de l' Anglais par le C. Lefevre, Paris: 1801, f. 109.

⁴ Πέτρος Φουρίκης, *Πόθεν το όνομα Σούλι*, "Ημερολόγιον της Μεγάλης Ελλάδος", Αθήναι: 1922, f. 405-406.

Sidoqoftë, brenda qarkut kuptimor të prejardhjes së toponimeve në këtë krahinë malore, një segment problemor mbetet çështja e burimit të emrit Sul. Fillimisht, një shpjegim jo fort bindës në këtë drejtim ofroi publicisti me prejardhje nga Korça, Petridhis, i vendosur në kryeqendrën e Greqisë gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX. I emocionuar më tepër pas “besueshmërisë efektive” të burimeve narrative, ai përkujtoi legjendën e banorëve të Kardhiqit, për të cilët vë në pah se ata “akomodohen” në viset shkëmbore, lart Paramithisë, pas ndjekjeve të egra të pushtuesit osman dhe të agait, të njohur me emrin Suli.⁵

Hë për hë, e konsideroj pak të besueshëm qëndrimin e Petridhit dhe më duket më i kapshëm mendimi i Furiqit. Ky i fundit i mbetet besnik qëndrimit se Sul me prapashtesën i do të thotë trung i drurit a lisit apo në instancën e fundit shtyllë.⁶ Sipas Furiqit, Sul-i (shul) është i njohur si emërvend dhe sot është i përhapur edhe tek arvanitofolësit e Salaminës⁷. Po ashtu si toponim, ka shtrirje të gjerë edhe në rrethin e Janinës, të Prevezës, të Marathonës afër Athinës dhe në katër fshatra të Moresë⁸. Sido që të jetë, kjo është një çështje e gjerë studimi ndërdisiplinor, për çka do të bëhet fjalë pas procedimit të disa qasjeve të tjera problemore, në këtë fushë studimi.

Suli e suljotët njihen pak në burimet relevante të kohës, por në literaturën ekzistuese kanë një përhapje të gjerë prezantimi. Nga baza e shkruar dhe e botuar, elemente të rëndësishme informimi për një analizë studimi jashtë kuadrit botues ballkanik vihen re dukshëm te veprat e udhëpërshkruesve evropianë. Në këtë kuptim, vlera të pamohueshme, pavarësisht mangësive të mundshme, reflektojnë materialet informative, veçanërisht të Pukëvilit (Pouqueville)⁹ e të Likut (Leake)¹⁰. Tek materialet e Etonit, Qiampolinit (Ciampolini), Hobhausit (Hobhouse), Doduelit (Dodwel), kjo gjë reflektohet më pak.

Kur bëhet fjalë për aktivitetin editorial të historiografisë greke, rruga më çon tek njëri ndër dëshmitarët e afërt të historisë së Sulit e banorëve

⁵ Α.θ. Πετρίδης, *Περί Σουλίου, Πανδώρα*, τ. ΙΗ, Αθήναι: 1867, f. 10.

⁶ Π. Φουρίκης, *Πόθεν...*, f. 415.

⁷ W. Eton, *Tableau historique ...*, f. 415.

⁸ *Po aty*, f. 419.

⁹ F.C.H.L. Pouqueville, *Voyage de la Grece...*, f.214-223.

¹⁰ W.M. Leake, *Travels in Northern Greece...*, f. 224-234.

të tij, greku Perevos¹¹. Ai ishte i pari që u njoh nga afër me suljotët pikërisht në Sul, pas vitit 1803 te Shtatë Ujdhesat e më tej në luftërat e vitit 1822, që suljotët zhvilluan kundër reparteve ushtarake osmane. Për një autenticitet të përafërt me Perevosin dallohet edhe Lambridhis¹², ndërsa Aravandinoi, autori i librit dyvëllimësh mbi Epirin, vë në dukje detaje mbi Sulin, me gjasë duke u mbështetur në referencat e Perevosit dhe krejtësisht pak, në hulumtimet personale. Ushqej mendimin se kontributi i epirotit Lambridhis është më i kapshëm edhe se kontributi i themeluesit të historiografisë moderne greke, Paparigopullosit. Lambridhis ofron një material të pasur, mbi të gjitha në planin hulumtues të historisë, atë të topografisë e të strukturës sociale të Sulit, aq sa për shumëçka plotëson dhe korrigjon të dhënat e dëshmitarit e biografit, Perevos.

Po të shohitet bagazhi i shkrimeve në këtë vijë studimi, këtu e shumë kohë më parë, vihet re përpjekja e një varg autorësh drejt pasqyrimin të rolit të fiseve suljote, brenda harkut kohor të viteve 1788-1825. Boshti interpretues ka si pikënisje dëshmitë gojore të vjela nga pasardhësit e familjeve të mëdha në Sul dhe të bartura prej tyre, brez pas brezi. Por në tërë këtë kompleks burimesh tregimtare, të gjithë kanë një mangësi kolektive: deficitin e vërtetësisë mbi popullimin e Sulit dhe forcën e dëshmisë së qëndrueshme mbi gjenezën e federatës së fiseve suljote, si tipar thelbësor i organizimit të tyre fisnor¹³.

Sido që të jetë, do t'i kthehesha paraprakisht, pak a shumë në gjerësi e thellësi, përpjekjes për të ofruar një paraqitje studimesh të deritanishme rreth prejardhjes etnike të suljotëve dhe kronologjisë të pranisë së tyre

¹¹ Perevos u njoh nga afër me suljotët pikërisht në Sul, te shtatë ujdhesat e Detit Jon pas 1803-së, si dhe në luftërat e tyre kundër reparteve ushtarake osmane gjatë vitit 1822. Shkroi librin për këta malësorë të papërkulur dhe për Sulin, që pati tri botime: të parin në Paris më 1803, të dytin në Venedik, më 1815 dhe të tretin në Athinë, më 1856. Lypset të përmendet se, në botimin e Parisit dhe të Venedikut, autori është “anonim”. Më gjerësisht shih: Χριστόφορ Περραιβός, *Ιστορία Σουλίου καί Πάργας*, Παρίσιοι: 1803, Βενετία: 1815, Αθήναι: 1856.

¹² I. Λαμπρίδης, *Ἡπειρωτικά Μελετήματα*, τεύχος 10, Τα Σουλιωτικά, Αθήναι, 1890; po ashtu τεύχος 3 (Κουρεντιακά και Τσαρκοβιστιακά), Αθήναι: 1888 dhe τεύχος 7 (Πωγωνιακά), Αθήναι: 1889.

¹³ Përzjashtim në këtë pikë vrojtimi, ku jepen disa të dhëna marginale, gjinden te: Αθ. Πετρίδης Μονή Στόλιου, “Νέα Ἐφημερής”, 2 shtator 1888; Po ai, “Περὶ Σουλίου, “Πανδώρα”, τ. ΙΗ, φηλλ. 422, Αθήναι: 1867; Π. Φουρίκης, *Πόθεν τὸ ὄνομα Σούλι...*, f. 404-420.

në Sul. Në këtë kontekst, aty këtu ndonjë shkrimtar i historisë, si Kuconikas¹⁴ rrëfen se suljotët janë banorë të hershëm në zonën lart lumit Aheron, ndoshta që nga gjysma e dytë e shek. XV. Po ashtu, bashkëvendësi i tij, Ath. Gudhas, në mungesë provash të drejtpërdrejta shtrëngohet të shfaqë mendimin se, pas vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, grupe shqiptarësh të krishterë ortodoksë nga terri mesjetar, diku rreth 200 persona, kryesisht të farefisit militarist të Boçarenjve e atij Xhavela, pas qëndrimit të shkurtër në zonat fushore të Epirit, zunë vend në Sul¹⁵. Sipas ndonjë përkrahësi të këtij mendimi, ata shqiptarë të Mesjetës, duke jetuar të izoluar nga të tjerët, në fakt po ruanin krishterimin ortodoks dhe karakterin luftarak¹⁶.

Në këtë pikë mendimi qëndron edhe Hr. Hristovasilis, i cili mbështetet në traditën gojore mbi bazën tregimtare të së cilës, pasardhësit e suljotëve ishin fortifikata e fundit e Skënderbeut, pas vdekjes së të cilit, ata zbritën drejt jugut, duke gjetur strehim në malet e Sulit¹⁷. Të tjerë autorë grekë, si J. Kordhatos, theksojnë se “suljotët ishin shqiptarë të krishterë nga Çamëria”¹⁸, ndërsa Novas e Dh.T. Boçari i japin dorë pikëpamjes se gjeneza e tyre ishte drejtpërsëdrejti nga Shqipëria¹⁹, mbase nga pjesa qendrore e saj dhe Delvina. Historianë evropianë, si Bertholdi²⁰ e Finley²¹, janë të njëzëshëm në përfundimin se suljotët kishin qenë pasardhësit e shqiptarëve të krishterë ortodoksë, nga dega e çamëve.

Nisur nga kjo hipotezë, ka të ngjarë që pas vdekjes së Heroit Kombëtar, arbitri mesjetar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, grupe të mëdha shqiptarësh të rrezikuar nga islamizimi si edhe nga lufta për mbijetesë në viset poshtë Shkumbinit, të kishin zënë vend përkohësisht në tokat pjellore të Çamërisë. Më vonë, me synimin për të ruajtur traditën e jetës

¹⁴ Λάμπρος Κουτσονίκας, *Γενική Ιστορία τής Ἑλληνικῆς Ἐπαναστάσεως*, τομ. 1, Ἀθήναι: 1863, f.2.

¹⁵ Αθ. Ν. Γούδας, *Βίοι παράλληλοι*, τομ. Η, Ἀθήναι: 1863, f. 46.

¹⁶ *Po aty*, f. 47.

¹⁷ Χρ. Χριστοβασίλης, *Αγώνες τού Σουλίου γιά τήν πατρίδα*, Ἀθήναι: 1901, f. 124.

¹⁸ Γ. Κορδάτος, *Ιστορία τής Νεώτερης Ἑλλάδας*, τ. Α, Ἀθήναι: 1957, f. 411.

¹⁹ Μὲ gjerësisht: “Διάλεξις Ἐθνικῆς Ἑκατονταετηρίδος” 1830-1930.

²⁰ Κ. Mentelson-Bartholdy, *Επιτομή ιστορία τής Ἑλληνικῆς Ἐπανάστασης* (përkthimi greqisht), pa vend dhe datë botimi, f. 23-24.

²¹ G. Finley, *Ιστορία τής Ἑλληνικῆς Ἐπανάστατέως* (përkthimi greqisht), Ἀθήναι: 1952, f. 39.

patriarkale, pra ligjet e maleve shqiptare, të parët e suljotëve marrin rrugën e ngjitjes nëpër qafën e maleve të Sulit. Në këtë kuptim supozimi, autorë shkrimesh nga fusha e studimeve suljote, para se gjithash, kujtojnë se ikjen masive të popullatës së krishterë drejt masivit malor të Sulit, e ndihmoi dukshëm ndrydhja e egër e pushtetit osman, me eksponentë të tyre, siç ishin çifligarët e Kardhiqit²².

Mirëpo, të gjitha këto mendime mbesin hipoteza, sepse jo pak herë ato qëndrojnë mbi shtyllat e burimeve tregimtare. Madje kjo vlen, edhe për dokumentet e shkruara, ato të shek. XIX, ku reflektohet pretendimi bindës rreth themelimit të vendbanimeve suljote. Nuk përjashtohet nga ky rrëfim edhe vepra e Perevosit, përndryshe burimit bazë për historinë e Sulit. Në botimin e parë dhe të dytë të historisë së tij, fryt i një pune angazhuese më tepër në terren, ky biograf fillet e themelimit të katër vendbanimeve suljote i identifikon aty kah mesi i shek. XVII, ndërsa në botimin e tretë kthehet prapa në kohë plot njëqind vjet. Në këtë rrafsh gjykimi, do të ishte fare e besueshme kjo, porse dyshimi për autenticitetin e teorisë së tij mbetet evidente sepse Perevosi, në botimin e fundit nuk i referohet asnjë elementi të ri²³. Rrjedhimisht, përcaktimi kronologjik për themelimin e katër vendbanimeve të Sulit është i vetëkuptueshëm, se mbështetet në traditën gojore, domethënë në kujtimet e tregimet e suljotëve të moshuar, të cilët autori i njohu nga afër, në kapërcyell të shek. XVIII²⁴.

Në përputhje me rrëfimet e të moshuarve suljotë, në atë rajon malor shtegtuan dhe zunë vend, në numër më të madh, blegtorët e fshatrave të

²² X. Περραιβός, *Ιστορία Σουλίου...*, f. 12.

²³ Në botimin e parë, atë të vitit 1803, Perevos përkujton se Suli nis jetën me suljotët 140 vite para motit 1803. Në botimin e dytë, nismën e funksionimit të jetës së Sulit e identifikon për 150 vite, siç duket 150 vite para motit 1815, ndërsa në të tretin rrit numrin e viteve të lashtësisë për 250 vite. Më gjerësisht për këtë: *Po aty*, botim i parë i vitit 1815, f. 20 dhe ai i vitit 1956, f. 57-58.

²⁴ “Nisur nga rrethanat dhe kushtet e lejueshme për këtë studim të paraqitur në lëmin e historisë, kemi biseduar me të moshuarit, gjeografët e pastaj edhe me historianë grekë, mbase të pajisemi me informacione më të sakta rreth emërvendit Sul, si dhe kronologjinë e fillimit të jetës aty. Por, të gjitha përpjekjet tona shkuan kot, sepse as për prejardhjen e emrit, as për malet e Sulit nuk gjetëm ndonjë përgjigje të besueshme. U detyruam, kështu, t’i drejtohemi subjekteve më të sigurta, priftërinjve dhe banorëve më mendjemprehtë të Sulit, për aq sa dinë e mbajnë në mend traditën dhe ndodhitë e historisë së tyre më të re”. Më konkretisht: *Po aty*, botim i vitit 1956, f. 36.

afërta, rrafshnaltave dhe viseve fushore, pas marrëveshjes ndërmjet tyre, pra ndërmjet blegtorëve të krishterë të fshatrave fushore e rrafshnaltave, jo larg Sulit²⁵. Së bashku me familjet e bagëtitë e veta, ata u larguan në një vend, ku ishin në dijëni se përmbushte kushtet për ekzistencë, duke ju shmangur kështu trysnive nga banorët fqinj të islamizuar. Mbështetur në këtë rrëfim, duket se, familjeve të para të blegtorëve që ju drejtuan Sulit, “në intervale” të ndryshme kohore do t’u bashkohen edhe familje të tjera nga disa fshatra, derisa numri i tyre në këtë zonë malore, arriti rreth 100 sosh²⁶.

Duke shfletuar literaturën vihet re se, afër biografit Pervos është edhe shkrimtari tjetër i historisë, Lambridhis, veprat e të cilëve, konsiderohen si dy burimet më të rëndësishme për të kaluarën e këtij rajoni malor, sipër Paramithisë. Dallimi ndërmjet tyre qëndron vetëm në mendimin e të parit se, suljotët janë përzierje e një klani të vjetër blegtorësh shqiptarë, të vendosur aty, duke i dhënë edhe emrin zonës, me atë të albanofonëve e grekofonëve të krishterë, të cilët zunë vend në Sul në fillim të shek.XVII, si pasojë e shmangies nga veprimet arbitrare osmane dhe hakmarrjeve farefisnore²⁷. Gjurmë identike në këtë pikë interpretimi, gjejmë edhe te P. e Sp. Aravandinoi²⁸ si edhe te shumica e udhëpërshkruesve të huaj²⁹.

Natyrshëm, për një çështje të gjerë e komplekse, nuk kanë munguar deri më sot, edhe devijime pak a shumë diametralisht të kundërta, lidhur me krijimin e kompleksit të katër fshatrave të Sulit. Kështu, pa vënë në dukje vendin e kohën e saktë, Gudhas e sheh krijimin e këtij kompleksi të “urbanizuar” nga një pjesë ushtarake e shqiptarëve ortodoksë, ithtarë të

²⁵ *Po aty.*

²⁶ X. Περραιβος, *Ιστορία Σουλίου*, botim i vitit 1956, f. 36.

²⁷ I. Λαμπρίδης, *Ηπειρωτικά Μελετήματα*, τ. 3, Ίωάννινα: 1971, f. 22 dhe τ. 10, f. 20.

²⁸ Π. Αραβαντινός, *Χρονογραφία της Ηπείρου*, τ. Β, Αθήναι: 1856, f. 156-157; Σπ. Αραβαντινός, *Ιστορία Αλή Πασά του Τεπελενλή*, τ. Α, Αθήναι: 1895, f. 66-67.

²⁹ Më konkretisht: F.C.H. Pouqueville, *Voyage de la Grece ...*, f. 210; T. Hughes, *Travels in Greece and Albania*, Vol.II, London: 1830, f. 139-140. Mbase, njëri ndër të rrallët udhëpërshkruesit evropianë, i cili ka një mendim të kundërt rreth themelimit të Sulit, është koloneli, diplomati dhe ballkanologu britanik, Lik, i cili, këtë rajon malor e konsideron koloni të shqiptarëve të Mesjetës, të cilët zunë vend në Epir gjatë shek. XII dhe fillimit të atij XIV. Më gjerësisht: W. M. Leak, *Travels in Northern Greece*, Vol. I, London: 1835, f. 234.

Skënderbeut³⁰. Petridhi, popullimin e kësaj zone e trajton si iniciativë të banorëve të fshatit Sulanë nga Dhivri i Delvinës, për të marrë rrugën e mërgimit pas ushtrimit të dhunës nga pushteti lokal osman³¹. Po sipas tij, me të mbërritur në këtë masiv malor mbi rrafshin e Çamërisë, “këta ardhacakë”, i vunë tokës së tyre të re emrin Sul-i, emër të cilin e mban edhe sot³².

Është me interes që në vëzhgimet e mëtejshme për këtë çështje, të vihet në spikamë edhe një qëndrim tjetër, i cili nuk mund të anashkalohet në kuadrin e studimeve për Sulin e suljotët. Bëhet fjalë për teorinë e autorit të librit historik mbi arvanitasit, K. Biris. Sipas tij në Dibrën e gegëve të Shqipërisë Verilindore, në Mesjetë ka ekzistuar një lokalitet me elementë të pastër grekë, elementë të cilët ai i vë në një korrelacion identifikimi me banorët e Dhivrit të Delvinës³³. Mendimin e tij rreth origjinës së suljotëve nga Dibra, ai e mbështet në një karakteristikë, që konsiston në qethjen e tamthit e të pjesës së përparme të kafkës³⁴. Mirëpo, ky qëndrim i Birit, vështirë se mund të jetë i kapshëm kur kihet parasysh fakti, se kjo dukuri e qethjes kishte përhapje të gjerë tek malësorët shqiptarë edhe në Shqipëri të Veriut, me çka ky fenomen do të ishte i veçantë, duke reflektuar origjinën e suljotëve nga Dibra³⁵. Po ashtu, nuk jam në dijeni se ndonjë lokalitet i Dibrës të ketë pasur grekë mesjetarë. Ka të ngjarë që qyteti me rrethinë, sipas dokumenteve historike kishte të bënte me praninë e shqiptarëve të ritit greko-bizantin. Po ashtu, nga baza dokumentare osmane e shek. XVI e regjistrimit kadastral për Sanxhakun e Dukagjinit, bëhet e ditur se në rajonin e Dibrës identifikohet një vendbanim, me emrin Shullan³⁶. Ky emërvend, pra

³⁰ A. N. Γούδας, *Βίοι Παράλληλοι των επί της αναγεννήσεως της Ελλάδος διαπρρεψάντων αντρών*, τ.Η, Αθήνα: 1874-1876, f. 46-47.

³¹ Αθ. Πετρίδης, *Περί Σουλίου, “Πανδώρα”*, τομ. ΙΗ, Αθήνα 1867, f. 265.

³² Κrh., *Μεγάλη Ελληνική Εγκυκλοπαίδεια*, τ. ΚΒ., f. 143.

³³ Κώστα Η. Μπίρης, *Αρβανίτες, οί Δωριείς τού Νεωτέρου Έλληνισμού*, Αθήνα: 1960, f. 286.

³⁴ *Po aty*.

³⁵ J.C. Hobhouse, *A journey through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia to Constantinople during the years 1809 and 1810*, London: 1813, f. 125; M. Hasluck, *The unwritten law in Albania*, Cambridge University Press 1954, f. 229.

³⁶ S. Pulaha, *Krahinat e Sanxhakut të Dukagjinit gjatë shek.XVI, “Studime historike”* nr. 3, f. 30 dhe nr.4, f. 180,190. viti bot.

Shullan-i, i cili gjendet edhe në rrethin e Delvinës, sipas K. Kristoforidhit identifikohet si vend me hije, hijerësi³⁷.

Nisur nga sa më sipër, dilemat rreth viteve e vendit nga zunë vend suljotët në Sul, janë më se evidente. Nuk dihet saktësisht, as kronologjia e as rajoni i natyrës fluide të tyre sepse materiali i prezantuar i Perevosit nga gurra popullore, po aq edhe baza toponomastike e shkrimtarëve të tjerë të historisë, janë larg vënies kapak të problemit të shtruar. Vështirësia rrjedh edhe nga fakti se lëvizja e gjerë e banorëve të fshatrave rreth Kardhiqit në drejtim të Sulit³⁸, fenomen të cilin Perevos e vendos me gjasë në shek. XVII, do të kishte lënë ndonjë gjurmë kujtese, sidomos në kushtet kur shumë fshatra atëkohë ishin të islamizuara, por jo gjithmonë të braktisura.

Sido që të jetë, masivi malor i përbërë nga katër vendbanime: Suli, Qafa, Samoniva dhe Avariko, ridel në skenën e historisë, në gjysmën e dytë të shek. XVIII³⁹, duke identifikuar krejt këtë rajon me veçantitë e veta që të tjerët poshtë tyre, nuk i kishin. Që atëherë, ato vendbanime njihen me emrin, “katër fshatrat e mëdha”, duke u shtrirë gjerë e gjatë anës lindore të masivit malor të Sulit dhe që për banorë të parë aty, identifikohen vetë suljotët⁴⁰. Po në shek. XVIII, ky masiv malor del i njohur edhe me emrin Kakosuli dhe banorët e tij kakosuljotët⁴¹, emërtim ky, që bartet në këngët popullore dhe në historiografinë e mëvonshme.

Sa i përket daljes në skenë të emrit Sul-i në shek. XVIII, Perevosi pohon se “nuk ndeshëm në asnjë burim të shkruar rreth emrit, kronologjisë dhe as për malet e Sulit”.⁴² Rrjedhimisht, kjo sjell dilema edhe mbi origjinën e banorëve të vendosur sipër Paramithisë së Çamërisë, që shpeshherë në filllet e shek. XIX duket se i kalojnë dimensionet e arsyes shkencore, duke shkelur hëpërhë në frymën e romantizmit, për

³⁷ K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, Prishtinë: 1977, f. 348.

³⁸ E.Δ.Μ., *Τα ήρωικά θαυμάτα...*, f. 5.

³⁹ Ι. Λαμπρίδης, *Τα Σουλιωτικά*, f. 8.

⁴⁰ Ι. Λαμπρίδης, *Ηπειρωτικά Μελετήματα...*, τ. 10, f. 10; Π. Αραβαντινός, *Χρονογραφία...*, τ. Α, f. 58; N.G.L.Hammond, *Migrations and Invasions in Greece and adjacent areas*, New Jersey: 1976, f. 9.

⁴¹ W. M. Leak, *Travels...*, Vol. A, f. 226; Ρο αι, *Researches in Greece*, London: 1814, f. 159; Α. Χ. Μαμμμόπουλος, *Ηπειρος, Λαογραφικά, ηθογραφικά, εθνογραφικά*, τ. Α, Αθήνα: 1961, f. 28-31.

⁴² Χρ. Πετραβός, *Ιστορία του Σουλίου*, botim i vitit 1956, f. 36.

epokën e artë të lashtësisë⁴³. Duket se, mangësia e provave bindëse, në një anë do të sjellë edhe mangësinë e logjikës së procedimit, por që gjithashtu, më pastaj, nxit këmbënguljen për të gjetur të vërtetën mbi etimologjinë e gjuhën e folur të banorëve të Sulit.

Ndër të parët, që mori guximin drejt hulumtimeve në këtë drejtim, ishte gjuhëtari Furiqi (Φουρίκης), i cili në hulumtimet e tij do të mbështetet në ato pak shkrime të shek. XIX, e më tej te përshtypjet e udhëpërshkruesve, si edhe në sfondin e këndvështrimeve të studiuesve më të vjetër dhe të atyre bashkëkohorë. Mbështetur në studimet e deriatëhershme, ai do të shkruante sa vijon: “ Sipas mendimit tonë zanafilla e fjalës Sul-i duhet rikërkuar parimisht në gjuhën e popullit, pra në faktin se cili ishte ai që zuri vend në ato male. Mbase, askush nuk mund të vërë në dyshim faktin se banorët e parë në ato lartësira heroike ishin shqiptarë. Po ashtu nuk duhet përgënjeshtroar fakti për kërkimin e rrënjës të fjalës [Suli] në gjuhën shqipe”⁴⁴.

Nisur nga një kundrim më i arsyeshëm vlerësimi sot, mendoj se gjykimi i Furiqit, mund të jetë më afër realitetit. Por, në këtë drejtim, është fare e mundshme shfaqja e ndonjë pikëpamjeje ndryshe rreth origjinës të toponimit Sul-i. Të reflektoj më qartë këtu: Mos në rastin konkret ndoshta bëhet fjalë për një emër njeriu dhe që rrjedhimisht shpreh relacion pronësie e vend krahine apo Sul-i, në një variant tjetër dëshmie më të fortë ka fuqinë e të vërtetës, e cila ka të bëjë me një emër topografik dhe jo për karakteristika gjeomorfologjie të këtij thepi malor ?

Në kuadër bredhjesh dhe dilemash, Perevos, ishte i pari, që përmendi traditën gojore të këtij rajoni malor, duke përkujtuar se baza onomastike e këtij emërvendi vinte nga një emër personi, dikur pronë e një otomani aty

⁴³ Kështu, Pukëvil në veprën e tij, *Voyage...*, Vol. II, f. 210-211, 222, 230, vendqëndrimin e parë të suljotëve e identifikon me emrin Selidha, duke e ndërlidhë atë me vendin e banorëve të sellëve të lashtë dhe njëherazi duke ju shmangur fillim e mbarim përmendjes, qoftë edhe më formale se suljotët janë më afër prejardhjes së tyre nga iliro-arbri. Në këtë qasje vrojtimi, disa autorë, bashkëkohës të konsullit francez në Janinë janë pak më të arsyeshëm, duke vënë në dukje se “ Sellët e lashtë ishin të parët banorë të Sulit dhe ku më vonë zunë vend suljotët ose mendimi tjetër se, Suli në fakt është Sili i lashtë, që pastaj nga shqiptarët e Epirit emërohet Kakësuli”. Më gjerësisht: T.S. Hughes, *Travels in Greece and Albania*, Vol.II, f. 139; I. Φιλήμων, *Δοκίμιον ιστορικόν περί της Ελληνικής Επανάστασεως*, τ.Β, Αθήνα: 1859, f. 346.

⁴⁴ Π. Φουρίκης, *Πόθεν το όνομα Σούλι*, f. 416-417.

afër, i njohur me emrin Suli⁴⁵. E pra, gjithnjë sipas mendimit të këtij biografi, ky pushtues aziatik “kishte cenuar skajshmërisht lirinë e mbijetesës së suljotëve, ndërsa këta të fundit, duke çmuar mbi të gjitha lirinë, braktisën vatrën e parë të tyre dhe zunë vend në Sul”⁴⁶. Ka mundësi që Perevosi të mbështetet në rrëfimet me ngjyrimë prej një miti, për të hedhur më pastaj “xhevahirin” se suljotët ishin ata, që vendstrehimit të ri i dhanë emrin e ndjekësit të tyre.

Duket se Lambridhis, në fushën e identifikimit të kësaj çështjeje të ndërlikuar studimore, është më realist dhe më i qartë. Kompleksin e katër fshatrave, me një onomastikë të përbashkët, ai e konsideron si prodhim që rrjedh prej udhëheqësit të tarafit të një brezi migrues, pra të një udhëheqësi ushtarak a klani çamësh, i njohur si Sul-i, prej nga, në përputhje me observacionet e tij, malet e thepitura sipër veriut të Paramithisë u thirrën me po këtë emër⁴⁷. Mendimit të Lambridhit më vonë do t’i japin dorë, aty këtu, edhe ndonjë studiues i historiografisë zyrtare greke të shekullit të kaluar, si Pulos⁴⁸ dhe Amandos⁴⁹, të cilët ndajnë mendimin e përbashkët se Sul-i është toponim në rasën gjinore, i këtij emri të përveçëm, që në instancën e fundit rrjedh nga emër personi, si Saul.

Për rrjedhojë, këta dhe disa autorë të tjerë shkrimesh historike, do të shfaqin mendime diametralisht të kundërta me atë të Furiqit, i cili është ithtar i qëndrimit se Sul-i prezanton emër topografik, që dëshmon tiparet morfologjike të vendit. Diku pranë tij, qëndron Petridhi, i cili edhe pse pranon toponimin si identifikim topografik, përmend fshatin Sulana, si vend të origjinës, prej nga nisi lëvizja e grupit migrues të suljotëve drejt Sulit⁵⁰. Sidoqoftë, kjo hipotezë lypset marrë me rezervë, nëse bëhet fjalë realisht për një terren të emërtuar nga konfiguracioni i vendit. Është i njohur fakti, se asnjë nga katër vendbanimet me emër të përbashkët Suli, nuk gjendet në majat e larta malore. Pra, ato nuk identifikohen me tipare

⁴⁵ Χρ. Περαιβός, *Ιστορία...*, (Botim i vitit 1956), f. 37.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ Ι. Λαμπρίδης, *Ηπειρωτικά...*, τόμος 3, f. 22.

⁴⁸ Ι. Πούλος, *Η εποίκηση των Αλβανών εις Κορινθίαν*, “Επετηρίς Μεσαιωνικού Αρχείου Ακαδημίας Αθηνών”, εν Αθήναις: 1950, τ. Γ. f. 82.

⁴⁹ Κ. Αμάντος, *Οι βόρειοι γείτονες της Ελλάδος*, Αθήνα: 1923, f. 74.

⁵⁰ Ky fshat, sipas këtij autori gjendet afër manastirit Stilo dhe Dhivrit të distriktit të Delvinës. Më gjerësisht: Α. Πετρίδης, *Περί Σουλίου*, “Πανδώρα”, τ. ΙΗ, Αθήναι 1867, f. 265.

geomorfologjie të terrenit, sepse janë të vendosura në një lartësi relativisht të vogël, deri në 600 metra, tek pjesët anësore të vargmalit, të shtrira nga ana lindore e tyre⁵¹. Vendbanimi Suli është i dukshëm vetëm nga krahët e Samonivës e të Qafës dhe që vetë ka dalje optike, gjithashtu në drejtim të këtyre dy vendbanimeve. Pra, Suli nuk gjendet në pozitë të dukshme, që të mund t'i arsyetonte karakteristikat e pikëvrojtimit, në drejtim të hapësirës mbikëqyrëse⁵².

Nga ky këndvështrim, grupe shqiptarësh fluidë, duke u nisur nga aspekti vrojtues i terrenit, do t'i jepnin vendstrehimit të ri Sul-i në qafën e malit, pra kah lartësitë, të cilat përmbajnë formën e shtyllës si dhe përparësitë e pamjes. Rrjedhimisht, ka mundësi që ata të ishin përcaktuar t'u japin pjesëve të qafës së lartësive të Sulit, emrat: Kungji⁵³, Bir⁵⁴, Vreke vetetime⁵⁵, Qafa (Kiafa)⁵⁶ si dhe majat e vargmalit në pjesët anësore, ku gjenden vendbanimet, Vuqi⁵⁷ e Flamburo⁵⁸.

Ka të ngjarë, kështu që emri Sul nuk ka prejardhje nga karakteristikat geomorfologjike të terrenit malor. Nëse shtrohen me kujdes trendet e pranisë së shqiptarëve në Epir përgjithësisht, krijohet përshtypja se ata lëvizin e zënë vend në Mesjetë, në shek. XIV e tutje, ndoshta edhe më

⁵¹ Γ. Μ. Σαρηγιαννη, *Η δημιουργία...*, f. 9.

⁵² Më gjerësisht, artikulli, d.m.th., zëri mbi Sulin në: *Μεγάλη Ελληνική Εγκυκλοπαίδεια*, τ. ΚΒ., Αθήνα: 1933, f. 142.

⁵³ Toponim me origjinë të gjuhës shqipe, që sipas Lambridhit do të thotë gardh i vogël: I. Λαμπρίδης, *Ηπειρωτικά...*, τόμος 3, f. 23; Ndryshe nga ai mendon udhëpërshkruesi dhe diplomati britanik në oborrin e Ali Pashë Tepelenës, Lik, i cili këtë emërvend e konsideron me kuptim vetëm nga shqipja, por që në të përkthyer do të thotë kodër: W. M. Leak, *Travels in Northern Greece*, Vol. A., f. 227; Π. Φουρίκης, *Πόθεν το όνομα Σούλι*, f. 406.

⁵⁴ Τ. Π. Γιοχάλας, *Το Ελληνο-Αλβανικόν Λεξικόν του Μάρκο Μπότσαρη*, Αθήνα: 1980, f. 282; Si toponim nga shqipja e identifikon edhe Lik; *Po aty*, f. 228; I. Λαμπρίδης, mendon se është fjalë shqipe nga dialekti i çamërishtes, që shqiptohet si ber: Si në shën. 39; Π. Φουρίκης..

⁵⁵ Vreke vetëtimë, sipas Lambridhit dhe Furiqit, tërheqin origjinën nga gjuha shqipe, që do të thotë shtylla e vetëtimës; Si në shën.40, f. 23, f. 406.

⁵⁶ *Po aty*, f. 23, 405.

⁵⁷ Furiqi e nxjerrë nga shqipja, që ka kuptimin e një bime: *Po aty*, f. 406.

⁵⁸ Lambridhis e identifikon si toponim nga gjuha shqipe, që do të thotë, flamur; Si në shënimin 42, τόμος 10, f. 23. Toponimi Flamburo identifikohet edhe si emër fshati i albanofonëve, në rrethin e Florinës. Për këtë, shih: Γ. Σαρηγιάννης, *Η δημιουργία, η εξέλιξη και η συγκρότηση...*, f. 52.

herët, të organizuar në grupe të mëdha farefisnie gjaku, në formë klanesh a fisesh dhe që secili nga ato identifikoheshin me emrin e të parit të fisit, pra të themeluesit dhe udhëheqësit të tyre. Të tillë kishte mjaft, si: Shpatajt, Loshajt e Mazarakasit. Pikërisht mbi bazat e atyre patronimeve, emërtohen edhe emërvendet, ku ata zunë vend në një rajon të caktuar⁵⁹. Në këtë drejtim, vihen re dy shembuj: pikë qëndrimet gjatë shtegtimeve të grupeve migruese prej shqiptarësh mesjetarë të Mazarakasve adaptuan emrat e themeluesve të fisit, si Mazaraqi në Kurenda dhe Mazaraqi në Çamëri.

Në favor të ithtarëve, të cilët i japin dorë hipotezës se Suli identifikon emrin e personit a vendin, pra jo atë gjeomorfologjik, dëshmon kalendari në dorëshkrim i Foto Xhavelës, i shkruar ndërmjet vitit 1792 dhe fillimit të vitit kalendarik 1793. Sa herë që njëri ndër figurat e dalluara të kësaj pjese të historisë përmend Sulin, e shënon në rasën dhanore “*στου Σούλη*”, pra në Sul⁶⁰. Po në këtë burim, në fjalinë “Viti tragjik, kur sundimtari ose pashai i Janinës, Aliu, thuri intrigën kundër banorëve të Sulit”, emri aty përmendet në trajtën gjinore njëjës, si “*Σουλίου*”, d.m.th., të Sulit. Tutje, me po këtë emër, Suli prezantohet edhe në këngën popullore: “E morën Sulin, e morën”⁶¹. Ndërkohë që disa vendbanime me emrin Suli, në bazë të regjistrimit të administratës venedikase të vitit 1700, figurojnë në Korint, në Patra dhe në Morenë Veriperëndimore⁶².

Mbase, e gjithë kjo reflekton një të vërtetë nga e kaluara e arbitrit mesjetar: Shqiptarët e kësaj epoke formojnë vendbanime, duke u vënë emrin e të parëve të fisit, siç është rasti në rajone të përmendura më lart, natyrshëm edhe në Epir e në Atikë. Pikërisht ky fenomen është element

⁵⁹ Σπυρ. Π. Λάμπρος, *Η ονοματολογία της Αττικής και εις την χώραν εποικήσης των Αλβανών*, εν Αθήναις, f. 31-32, 34; Π. Φουρίκης, Συμβολή εις το τοπωνυμικόν της Αττικής, “Αθηνά” 41, εν Αθήναις: 1929, f. 128-129, 134; Ι. Πούλος, Η εποίκησης των Αλβανών εις Κορινθον, “Επετηρίς Μεσαιωνικού αρχείου Ακαδημίας Αθηνών”, τ. Γ. f. 80; G. Schiro, *Cronaca dei Tocco di Cefalonia*, Anonimo, Prolegomeni, testo critico e traduzione, Roma: 1975, vargu 1497, 1826, 2303, 2312.

⁶⁰ *Γενικά Αρχεία του Κράτους* (më tej: Γ.Α.Κ.), Κ. 88, Fondi Foto Xhavela, Shënimi 7.

⁶¹ W. M. Leak, *Researches in Greece...*, f. 160.

⁶² Më gjerësisht: Β. Παναγιωτοπούλος, *Πληθυσμός και οικισμοί της Πελοποννήσου 13ος-18 αιώνας*, Αθήνα: 1985, f. 229, 241, 255, 273, 276, 291, 304, 305.

substancial vetëm për pasardhësit e tyre. Në këtë kuptim, terreni afër Sulit ose edhe vetë Suli duhej të ketë qenë vendqëndrim i përkohshëm i ndonjë grupi shqiptarësh nomadë që ishin fluidë, duke kërkuar kushte më të favorshme për mbijetesë diku tjetër. Ky model lëvizjesh shtegtuese, sjell njëkohësisht edhe bartjen e toponimeve, nga njëri vend në tjetrin, çka sipas medievistit gjerman, Georg Shtadtmyller (G. Stadtmüller) është një provë e fortë, për historinë e ngulimeve të grupeve migruese⁶³.

Nisur nga emërvendet e pranishme të gurrës shqipe, vjen përfundimi i pakontestueshëm se suljotët ishin shqiptarë të krishterë të besimit ortodoks⁶⁴. Nëse kjo del e zyrtë tek Pervos, tek autorët e tjerë, përfshirë edhe ata grekë, apo ndër burimet e shkruara e gojore, origjina e tyre shqiptare është më se e evidente. Kështu, Lambridhis⁶⁵ është mjaft kategorik rreth kësaj çështjeje. Ai këmbëngul tek fakti se “suljotët janë një përzierje e ngulimeve të para të shqiptarëve dhe e një grupi grekësh aty afër, diku nga shek. XVII, si pasojë e akteve të dhunshme të otomanëve, duke zënë vend kështu, në Sul”⁶⁶. Pranë mendimit të tij qëndrojnë edhe disa shkrimtarë tjerë grekë të historisë suljote si: P. Aravandinoi⁶⁷, Sp. Aravandioni⁶⁸, Paparigopullos⁶⁹, Ap. Vakalopullos⁷⁰, etj. Këtë mendim e mbështesin edhe udhëpërshkruesit e diplomatët evropianë të akredituar në oborrin e Ali Pashë Tepelenës në Janinë si: Pukëvili⁷¹, Liku⁷² dhe Holland⁷³.

⁶³ G. Stadtmüller, *Τα προβλήματα της ιστορικής διερευνησεως της Ηπειρου*, “Ηπειρωτικά Χρονικά”, τ.9, Αθήναι: 1934, f. 164.

⁶⁴ Në funksion të patronimit, burimet historike përmendin disa stratotë shqiptarë në shërbim të Republikës së Venedikut nga Gadishulli i Moresë, si: Gionis (Jani), Dimas (Dimo), Marco (Mark), Nicolla (Nikollë) e Petro Suli. Më gjerësisht : C. N. Sathas, *Documents relatifs à l'histoire de la Grèce au moyen âge*, Vol.VIII, Paris: 1880-1890, f. 351.

⁶⁵ I. Λαμπρίδης, *Ηπειρωτικά Μελετήματα*, τ. 3, f. 22, 27 dhe τ. 10, f. 20.

⁶⁶ I. Λαμπρίδης, *Σουλιωτικά...*, f. 20.

⁶⁷ Π. Αραβαντινός, *Χρονογραφία...*, f. 155-157.

⁶⁸ Σπ. Αραβαντινός, *Ιστορία Αλη Πασά...*, f. 66-67.

⁶⁹ Κ. Παπαρρηγόπουλος, *Ιστορία του Ελληνικού Έθνους*, τ. Ε, Αθήναι: 1860-1874, f. 441.

⁷⁰ Απ. Βακαλόπουλος, *Ιστορία του Νέου Ελληνισμού*, τ. Δ, Θεσσαλονίκη: 1961, f. 349.

⁷¹ F.C.H.L. Pouqueville, *Voyage de la Grèce...*, f. 211, 222, 230.

⁷² W.M. Leak, *Travels in Northern Greece*, Vol.I, London 1835, f. 23-235.

Në favor të së vërtetës rreth origjinës shqiptare të suljotëve, dëshmon edhe muza popullore. Kështu, në një frymëzim poetik, që himnizon zbarkimin e reparteve ushtarake nën drejtimin e rusëve te Shtatë ishujt e Detit Jon, më vonë nën administrimin francez, suljotët dhe disa kapedanë himarjotë përbëjnë kompanitë ushtarake shqiptare. Në vitin 1807, suljotët ishin në ballë të betejës në Tenedin ndërsa nga ushtarakët e Napolonit trajtohen për bartës të “regjimentit shqiptar”. Për këta të fundit, suljotët ishin refugjatë, që quhen “arvanitë” ose “albanezi”⁷⁴. Ajo ç’është me interes dhe për çka e konsideroj faktor gjykimi të arsyeshëm e me peshë të posaçme, është e vërteta e pakontestueshme për origjinën e tyre shqiptare, e cila gjen mbështetje të fuqishme edhe në bazën jo të paktë të shkruar burimore greke⁷⁵. Ndërkaq, si pjesë e patjetërsueshme e etnisë shqiptare, suljotët prezantohen aty këtu edhe me ngjyrimet e errta, në veprimet e jetës së tyre të përditshme⁷⁶.

⁷³ H. Holand, *Travels in Jonian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia during the years 1812-1813*, London 1815, f. 448.

⁷⁴ A. Boppe, *L’Albanie et Napoléon*, Paris: 1914, f. 219; Një burim frymëzimi për suljotët shfaq edhe rilindësi dhe mbledhësi i zellshëm i folklorit burimor shqiptar, Thimi Mitko. Kështu rënien e Sulit në duart e Ali Pashë Tepelenës si dhe heroizmin e pashembullt të tyre, po ky e përshkruan vargun me përshtypje të thellë, si: “Se ç’u prem’e se ç’u vramë, Sul’e shkretë ku e lamë”. Më gjerësisht: Th. Mitko, *Mbledhësit e hershëm të folklorit shqiptar II*, Pjesa e parë, Tiranë: 1961, f. 105-106.

⁷⁵ “Αλβανίτες”, d.m.th., shqiptarë i identifikon edhe Eleni Karakicu, bashkëshortja e parë e Marko Boçarit. Ajo në fakt drejton një kundër akuzë ndaj tij e familjes së tij, si përgjigje rreth një procesi gjyqësor për çështje shkurorëzimi të parashtruar nga vetë Marko Boçari më 1810, në shtatë ujdhesat e Detit Jon. Ndërmjet tjerash, Karakicu akuzon indiferencën e vjehrrive të saj me fjalët: Nëse ai i kishte të gjitha gjërat në duart e veta, se vjehrrit dhe vjehrra ime nuk vendosen ta zënë e ta vrasin, sa Kostën e Stathit, po aq edhe këtë ta bëjnë për mua dhe se sipas tyre e kanë tradhtuar, atëherë veprimi i tillë është borxh dhe ligj për shqiptarët, që të lahen nga mëkati. Më gjerësisht: Γ.Α.Κ, Arkivi i Rrethit të Korfuzit, Fondi “Mitropolit” Akti 189; Gjithashtu, si “arvanitë”, ata identifikohen edhe në katalogët onomastike të të huajve në Korfuz, një pjesë e të cilëve figurojnë si banorë të fshatrave: Strugli, Stavro e Benica. Më gjerësisht: Γ.Α.Κ, Arkivi i rrethit të Korfuzit - Të dhëna për të huajt, Raporti 59, dhjetor 1815.

⁷⁶ “Të mësuar me jetën luftarake, ata përbuzin punën e bujkut ose në instancën e fundit nuk u nënshtrohen as rusëve. Duke vjedhur dhe grabitur bagëtinë e fshatrave përreth Korfuzit, ata refuzojnë t’i kthehen zellit për paqe sepse asgjë tjetër nuk njohin, përveç se të pastrojnë armët dhe të këndojnë me kitarë në shqipet

Sa i përket organizimit shoqëror të suljotëve, literatura historike dhe baza sado e paktë burimore e shkruar, lënë përshtypjen se ata ishin të organizuar në fara, fise, klane a familje të mëdha. Ka të ngjarë që kjo formë e organizimit fisnor të ketë qenë identike me grupet migruese të shqiptarëve, ku burimet e shkruara mesjetare të fillimit të shek. XIV, i karakterizojnë si fise, të cilat nuk njohin pushtetin e mbretit, pra që janë “ἀβασίλευτοι”⁷⁷. Rrjedhimisht, gati pesë shekuj më vonë, ata do të cilësohen si mjedis “anarkik” jashtë kontrollit të pushtetit qendror, i veçantë vetëm për organizimin shoqëror të grupeve blegtorale, me tipare shtegtimi.

Sidoqoftë, duke analizuar rrjedhat historike të strukturës shoqërore të suljotëve, duket se ata janë të organizuar sikurse shqiptarët e rajoneve malore të Shqipërisë Veriore. Kështu, gjatë viteve 1720-1740, fshatrat e Sulit tashmë ishin formësuar krejtësisht, duke ndërtuar aty vendbanime të qëndrueshme, ndërsa banorët e kësaj pjese të Greqisë u ishin përkushtuar blegtorisë dhe organizimit të jetës patriarkale.

Që atëherë, ndoshta edhe më herët, katër fshatrat e mëdha të këtij rajoni të zhveshur e shkëmbor sipër Çamërisë ndahen në farefise ose familje të mëdha. Sipas Pervos, në vendbanimet e Sulit mbijetonin 450 familje me 22 farefise, ndër të cilat më të njohurat ishin: Boçarenjtë, Xhavelasit, Drakajt, Dangliajt, Buzajt, Seatët, Nikajt, Papajanët, Shahinajt dhe Kalogjeratët⁷⁸. Qafa në këtë organizim dhe strukturë shoqërore të suljotëve kishte 4 farefise me 60 familje, ndër të cilat dalloheshin farat: Zerva dhe Nikaj⁷⁹. Së bashku me farefisët e Avarikut e të Samonivës, ato prej kohësh do të përbënin një potencë lufte dhe hera herës në kushtet e mbijetesës, element i pashmangshëm plaçkitjesh të organizuara, në pronat jashtë komunitetit të tyre.

Në bërthamën e këtij organizimi, emri i suljotëve lakohet si një element mobilizimi në planin militarist për meshkujt prej moshës 16 deri në atë 70 vjeçare⁸⁰. Ndërkaq, çështja e frymës dhe e moralit rezistues

heroizmin e tyre”. Më gjerësisht: Π. Χιώτης, *Ιστορικά, Απομνημονεύματα*, Κέρκυρα: 1863, f. 857.

⁷⁷ I. Cantacuzeni, *Eximperatoris demonstrationes*, libri I, Ed. Weber, Bonnae: 1828-1832, f. 28, 474.

⁷⁸ Χρ. Περραιβός, *Ιστορία Σουλίου...*, τ. Α., Βενετία: 1857, f. 32.

⁷⁹ *Po aty*, f. 62.

⁸⁰ Γ. Σαρηγιάννης, *Η δημιουργία...*, f. 26.

shkoi aq larg, sa në sistemin e kultivimit të artit të luftës do të inkuadrohet edhe gruaja. Ajo, në rast gjendjeje lufte brenda Sulit, kryente funksionin e furnizimit, pra kishte rolin e krahut ndihmës, madje edhe të sektorit të rregullt të shërbimit ushtarak⁸¹.

Megjithatë, siç bëjnë të ditur Pervos e Lambridhis, një varg kompetencash qëndronin në pushtetin e udhëheqësit, i zgjedhur nga këshilli i farës a i fisit. Rreth funksionimit të këtij këshilli, ky i dyti i referohet një të dhëne të tërthortë, sipas të cilës “Çdo fyerje ndaj individit konsiderohej sulm ndaj atdheut”, për çka në raste të tilla, udhëheqësi ftonte këshillin dhe merrte masën ndëshkuese⁸², ndërsa vendimi i këtij organi ishte fryt i autoritetit të pakontestueshëm të tij. Vendimmarrës ishte po ashtu edhe roli i tij në rrethanat kritike për sigurinë, kompaktësinë dhe nderin e farefisit. Nisur nga ky “unitet”, burimet dhe literatura në fillet e gjysmës së parë të shek. XVIII informojnë për një realitet ekzistues. Suljotët kishin arritur tashmë të formonin federatën ose konfederatën e fiseve të Sulit. Për më tepër, ata shenjëzojnë vijën e kuqe, e cila përkufizonte pushtetin e tyre, me qytetet: Filipiada-Carkovicë-Paramithi-Margëllëç-Pargë.⁸³

Duke udhëhequr jetën e izoluar nga të tjerët, pra larg rrymave të ndryshme të kulturës së shek. XVIII, madje edhe më vonë, ata do t'i përmbahen vijës së dispozitave të së drejtës së tyre zakonore. Në këtë kuptim, te malet e zhveshura të Sulit sundoi praktika e hakmarrjes si një fenomen, që njihet në jetën patriarkale të fiseve në Shqipërinë e Veriut. Në Fjalorin shqip-greqisht të Marko Boçarit, përmendet fjala “hasm”, që ka kuptimin e armiqësisë dhe të armikut⁸⁴ si edhe fjala “hake”⁸⁵ (hak), që do të thotë, hakmarrje, marr hakun, term ky që përdoret në gjuhën shqipe, por i huazuar nga turqishtja. Ndërkaq, në po këtë thesar të çmuar për leksikografinë shqiptaro-greke, e shkruar nga dora e vetë Marko Boçarit, figuron termi “gjak”⁸⁶, që ka kuptimin e borxhit të hakmarrjes të një individi, në praktikën zakonore të Sulit. Duke ju përmbajtur këtij kriteri zakonor, në fillet si dhe rrjedhën e mëtejshme të konfliktit merrnin pjesë përkrahësit e palëve të hasmuara, pra krejt pjesëtarët farefisnorë të vijës

⁸¹ *Po aty*.

⁸² I. Λαμπρίδης, *Ηπειρωτικά...*, τ. 10, f. 28.

⁸³ *Po ai*, *Σουλιωτικά...*, f. 7.

⁸⁴ T. Γιοχάλας, *Το Ελληνο-Αλβανικόν Λεξικόν...*, f. 241.

⁸⁵ *Po aty*, f. 164, 212.

⁸⁶ *Po aty*, f. 132.

patriarkale. Kjo ndodhte se pjesëmarrja e farefisit në grindjet personale të një anëtarit të tij trajtohej si “një obligim i tërë sojit”⁸⁷. Nëse konflikti rezultonte me vrasje, atëherë pasonin vrasjet e ndërsjella ndërmjet familjeve të mëdha në hasmëri.

Roli që kishte gruaja në ndërmjetësimin dhe zhdukjen e hasmërive, ishte një fenomen i rrallë, porse për komunitetin suljot fare i zakonshëm. Perevos kujton se gruaja suljote mund ta kryente atë rol, nga shkak i ndërgjegjes së burrave të Sulit, që i konsideronin ato si qenie, para të cilave ishte e turpshme dhe shpirtvogëlsi, bërja e rezistencës⁸⁸. Megjithatë, motivi i vërtetë, që i bënte gratë të ndërhynin në konflikte burrash, qëndronte pikërisht në faktin se ato mund të evitonin rrezikun e akteve të vrasjeve. Po sipas, Perevosit, suljotët u nënshtroheshin një ligji, që sanksiononte vrasjen e një gruaje, të barabartë me një numër të konsiderueshëm burrash të farefisit të vrasësit, pra të barabartë me numrin e fëmijëve të një nëne. Roli ndërmjetësues i grave nuk ishte gjithnjë i suksesshëm. Sigurisht që konfliktet e familjeve të mëdha suljote, duke shfaqur probleme të theksuara në bërthamën e komunitetit të tyre, shpeshherë manifestoheshin me vrazhdësi të veçantë. Në këtë kuptim, literatura historike vë në dukje lëvizje farefisesh ose degësh të tyre në fshatrat fqinje, si pasojë e rrezikut dhe frikës nga hakmarrja e pashmangshme⁸⁹.

Struktura ekonomike e suljotëve ishte në përputhje me nivelin e zhvillimit shoqëror të tyre. Krahasuar strukturën e fshatrave fqinje, ajo ishte kryesisht një strukturë e vonuar. Biografi Perevos kujton se “suljotët janë laikë në fushën e njohurive për artin dhe tregtinë dhe se fusha e veprimit të përditshëm të tyre është blegtoria”⁹⁰. Pasardhësi i tij për studimet suljote, Lambridhis është më radikal në vlerësime për këta malësorë me origjinë shqiptare, duke shtuar se “Të vetmen veprimtari në përditshmërinë e tyre, ata kanë blegtorinë dhe plaçkitjen”⁹¹. Ç’është e drejta, suljotët merreshin me punët agrare vetëm nëse ndërmjet farefisëve ekzistonte konflikti, për çka ata detyroheshin të lëviznin dhe të zinin vend në vise fushore⁹².

⁸⁷ Χρ. Πετραβός, *Ιστορία...*, botim i vitit 1956, f. 61.

⁸⁸ *Po aty*.

⁸⁹ Ι. Λαμπρίδης, *Ηπειρωτικά...*, τ. 10, f. 27.

⁹⁰ Χρ. Πετραβός, *Ιστορία...*, f. 12.

⁹¹ Ι. Λαμπρίδης, *Σουλιωτικά...*, f. 30.

⁹² *Po aty*, f. 27.

Në aspektin gjuhësor, mirëfilli dihej se suljotët e masivit malor të Sulit ishin pasardhësit e shqiptarëve nomadë, të cilët prej kohësh përbënin një potencë të fuqishme politiko-ushtarake në Epir. Ashtu të mbyllur në rajonin malor sipër Çamërisë, ata flitnin shqip, duke udhëhequr për shumë kohë jetë të izoluar, ashtu të heshtur e pa u dëgjuar nga të tjerët. Ishin, aty këtu të rrethuar nga grekofonë, të shtrirë në rrafshnalta dhe në vise fushore. Koloneli i artilerisë britanike, Lik (Leak), ishte kategorik kur nënvizonte se “Suljotët nuk ishin grekë, por shqiptarë të krishterë. Në shtëpitë e tyre, ata flitnin gjuhën shqipe edhe pse të gjithë burrat e Sulit e shumë nga gratë e tyre kanë komunikuar edhe në gjuhën greke”⁹³.

Për të parë gjuhën e folur të suljotëve shërben Fjalori shqip-greqisht i Marko Boçarit, i shkruar prej tij në Korfuz në vitin 1809, siç duket me kërkesën e konsullit francez në Janinë, Pukëvil⁹⁴. Në përputhje me botuesin dhe komentuesin e tekstit, Johalas, vihet në dukje se pjesa shqipe e fjalorit i përket dialektit toskë të Shqipërisë së Jugut. Ai përmban mjaft elemente gjuhësore arkaike, të cilat sot korrespondojnë me shqipen e folur të arbëreshëve të Italisë. Për më tepër, ky autor konsideron se shumë elemente të së folmes shqipe të dialektit çam, si ato të fshatit Kanelaqi dhe posaçërisht të fshatit Rapëza (sot Anthusa) më së pakti zënë vend, në leksikon e Fjalorit shqip-greqisht të Marko Boçarit⁹⁵.

Megjithatë, disa konkluzione, si ai se, Marko Boçari bën gabime sintaksore më tepër në shqip e më pak në greqisht apo se dialekti çam nuk është shqipja e folur në fjalorin e tij, duhet marrë me shumë rezervë. Mbase, nuk duhet harruar fakti se Fjalori u shkrua në vitin e largët 1809, pra pikërisht atëherë kur sa kishte filluar me ritme të ngadalshme procesi

⁹³ W. M. Leak, *Researches in Greece...*, f. 414.

⁹⁴ Këtë thesar të çmuar të leksikografisë shqiptaro-greke e zbuloi Spiro Lambros në Bibliotekën Nacionale të Parisit, brenda fondit të dorëshkrimeve Supplément Grec 251. Ishte dhuratë e vetë Pukëvilut për këtë institucion në vitin 1819. Dorëshkrimi prezantohet me faqen 25 dhe 24 se të tjerat mungojnë. Më gjerësisht për historikun dhe anën gjuhësore të Fjalorit shqip-greqisht: Σπ. Λάμπρος, *Ο Μάρκος Μπότσαρις λεξικογράφος*, “Εστία”, ἐν Ἀθήναις, 25.12.1895, f.4; F. Konica, Marko Boçari auktor “Albania” II, Bruxelles: 1898, 4, f. 56-58; L. Skendo (M. Frashëri), Fjalori i Marko Boçarit, “Kalendari Kombiar”, Tiranë: 1926, f. 120-196; Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe 1332-1850*, Prishtinë: 1978, f. 165; T. Γιοχάλας, *Τό Ἑλληνο-Ἀλβανικόν Λεξικόν ...*, f.35-418; J. Kastrati, *Historia e Albanologjisë*, Tiranë: 2000, f.461-480.

⁹⁵ T. Γιοχάλας, *Τό Ἑλληνο-Ἀλβανικόν Λεξικόν ...*, f. 48-49.

i “ndërgjegjësimi kombëtar” tek popujt ballkanikë, në shumëçka i dalluar, prej atij të shek. XVI-XVII. Po ashtu, në këtë kontekst, duhet pasur parasysh edhe niveli arsimor i Marko Boçarit rreth sajimit të Fjalorit, jo vetëm të pjesës shqipe, por edhe të asaj greke, po aq sa edhe mungesën e një alfabeti të veçantë të shqipes si dhe përkthimin e fondit leksikor të shqipes me alfabetin grek. Rrjedhimisht, kur zihet ngoje vetë përdorimi i fjalëve në shqipe me alfabetin grek, kjo dukuri që e pranishme te shqiptarët e krishterë ortodoksë, edhe tutje Kalamasit.

Nisur nga sa më sipër, në Çamëri si dhe në rajonin e gjerë të Epirit, korrespondenca e shkruar ndërmjet shqipfolësve bëhej drejtpërsëdrejti në greqisht, gjuhë të cilën, me gjasë e flitnin një numër i madh banorësh, ndërkohë që në këmbimet zyrtare, ata shfrytëzonin sekretarët grekë. Kështu, në greqisht bëhej edhe korrespondenca e bejlerëve çamë me Ali Pashë Tepelenën⁹⁶. Po në këtë gjuhë, bejleri i njohur i Çamërisë, Hasan Çapari i drejtohej në dy dokumente, shqipfolësit Foto Xhavela.⁹⁷

Sidoqoftë, niveli i njohjes së shqipes po aq sa edhe i greqishtes, jo vetëm i Marko Boçarit, por edhe i suljotëve të tjerë të dëgjuar, nuk ishte në atë shkallë të kënaqshme, sipas të gjitha paragjykimeve objektive, nga shkak i mungesës së arsimimit të tyre⁹⁸. Kështu, në fjalorin e krye heroit të Sulit vihet re mangësia e pranisë së strukturës gjuhësore në shqip dhe greqisht. Po ashtu edhe mungesa e përvojës në të shkruar, sa e tij aq edhe anëtarëve të tjerë të farefisit Boçari, të cilët duhet ta kenë ndihmuar gjatë përpilimit të fjalorit shqip-greqisht, është e dukshme.

⁹⁶ Në Arkivin e Ali Pashë Tepelenës në Bibliotekën “Genadion” të kryeqendrës së Greqisë dhe që i tërë ky material është shfrytëzuar dhe botuar tani vonë, konfirmohet korrespondenca e “Luanit të Epirit” me shumicën e oficerëve ushtarakë të Pashallëkut të Janinës, si dhe me përfaqësuesit e tij në Stamboll, të gjitha letrat e Ali Pashë Tepelenës janë të shkruara në greqishte, pikërisht nga sekretarët e tij. Shi për çudi, edhe vetë dërgesat e letrat të marra nga bejlerët çamë, po edhe ato nga Shqipëria e Jugut, janë gjithashtu të shkruara në gjuhën greke. Më gjerësisht: Σπ. Π. Αραβαντινός, *Ιστορία Αλη Πασά ...*, τ. Β, f. 460.

⁹⁷ Γ.Α. Κ., Κ. 88, Fondi Foto Xhavela.

⁹⁸ Te shumë suljotë të dëgjuar mungonin njohjet e tyre në fushën e gramatikës, të sintaksës dhe madje edhe të ortografisë greke. Në këtë drejtim, edhe vetë Marko Boçari mësoi pak a shumë gjuhën e thjeshtë të shkruar greke nga një prift me arsimimin modest. Për këtë: Γ.Α.Κ, Fondi i Foto Xhavelës, Κ.88; Σπ. Μεταξάς, *Βιογραφική ιστορία του αθανάτου ήρωος Μάρκου Μπότσαρη*, Κέρκυρα: 1831, f. 43.

Niveli i ulët arsimor i suljotëve ishte pasojë e mungesës së shkollave në Sul⁹⁹ si dhe e fuqisë së madhe vendimmarrëse, pra larg koherencës me botën e qytetëruar, duke qenë kështu të varur nga strukturat e organizuara arkaike të tyre. Ata patën për shumë kohë prioritetin tjetër të përditshmërisë jetësore, që bazohej në një arsimim të kundërt: atë të përvetësimit të artit luftarak, pra të përdorimit të armës, duke e bartur përvojën e kësaj veprimtarie nga njëri brez në tjetrin. Për këtë arsye, nuk ishte e rastit që suljotët vijojnë jetën nga kujtimet ende të freskëta të rezistencës e të luftës edhe pas rënies së Kungjit, fortifikatës së fundit të tyre, në dhjetorin e vitit 1803.

Kjo mendësi mbijetoi edhe atëherë kur ata gëzuan statusin e shtetasve të huaj në Korfuz e në Shtatë Ujdhesat e Jonit, nën mbikëqyrjen e administratës ruse, franceze dhe angleze. Ashtu të mbyllur në lëvozhgën e tyre të jetës patriarkale, suljotët mbetën edhe atje jashtë sistemit arsimor, të paktën pjesërisht, deri në mesin e viteve 30-të të shek. XIX. Deri atëherë, ata përkujtuan me mall jetën patriarkale të paraardhësve të tyre, doket e zakonet, pa anashkaluar edhe gjuhën e folur, ndryshe nga të tjerët. Suljotët ishin ata, të cilët e kujtonin dhe e respektonin të kaluarën, të cilën e identifikonin me ligjet e “maleve shqiptare” dhe e riprodhonin jo rrallë në legjenda të bukura rrëfimi, rreth historisë të një pjese të Epirit malor.

S u m m a r y

SCHOLARLY PERSPECTIVES ON SULI AND THE SULIOTS

According all data available, from the beginning of the 16th century the political history above Paramithia of Camuria becomes part of Suli and its inhabitants, the Suliots. Until then, the documentary sources, oriental or western, do not give any relevant proof that in those treeless mountains there were signs of life. In this context, the Suliots were the first to settle there; most

⁹⁹ Mungesën e shkollave në Sul e vë në dukje edhe njohësi i mirë i historisë së tyre, Perevos, ndërsa Lambridhis bën fjalë për një shkollë aty afër kishës së Shën Gjergjit, por me gjasë e karakterit fetar, në kuadrin e lutjeve të përditshme. Më gjerësisht: I.Λαμπρίδης, *Ηπειρωικά Μελετήματα*, τ. 10, f. 18.

probably they gave the name to their “new motherland” and living isolated they build the myth of their patriarchal life.

However, their history and deeds attracted the curiosity of many authors and chronicles. Therefore, there are many historians who contribute with their written records in the understanding of the origin, life, customs and traditions of Suli and the Suliots. In this framework, not only in the past, but also nowadays, the dilemma especially about their ethnic origin is still present in the Suliote studies. However, as explained in several studies about Suli and its first inhabitants, it is clear that the language that predominated in everyday communication was Albanian; as for their social organization they were divided based on kinship relations, an organization identical with that of the large Albanian tribes.

Separated from the low-lying tribes, at least until the beginning of the 18th century they preserved their linguistic identity, their sacred qualities of patriarchal life, respect for the head of the tribe, the military character of this institution, and according contemporary sources, in 1730 the number of large families that were ready to organize the resistance against any foreign invader had reached 100. Moreover, in these conditions, according reliable sources, they advanced further in their social organization, establishing a federation of Suliote tribes. They did not borrow anything from the others’ living model, as they were closed in their nutshell; living in the treeless mountains of Suli, they preserved their mother tongue, Albanian, while enriching the toponyms and micro toponyms with Albanian words; being particular in many aspects they become subject of study for many foreign writers and diplomats from civilized Europe.

Perhaps, many of them came to firm conclusions that the Suliots were of Albanian ethnicity, because of their language, customs and traditions, leaving unexplained only their territorial origin before they settled in Suli. Anyhow, the Suliots continued to be representatives of the Albanian world together with their features, several years after 1803, when they left Suli and emigrated to Parga and Corfu.